



INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE



RELACION TEKNIK

Mbi

Projektin e Restaurimit

“Kisha e Shën Todrit” Kadipashaj, Lushnjë

Punoi: Ark. Ronela Çuku

MIRATOHET

Ing. Bledian Rakipi

PËR K.K.T.K.M.

SEKRETARI

JOLI MITROJORGJI

TIRANË 2025



PËRMBAJTJA:

1. VENDNDODHJA.....	2
2. ANALIZA HISTORIKO – ARKITEKTONIKE.....	3 - 4
- Të Dhënat Historike.....	3
- Analiza Arkitektonike.....	3
- Bibliografia.....	4
- Fazat e ndërtimit të kishës.....	6
- Rilevime të vjetra nga Arkivi i IKTK.....	7
- Foto gjendja ekzistuese.....	7
3. NDËRHYRJET NDËR VITE.....	7
4. GJENDJA E KONSERVIMIT.....	8
5. NDËRHYRJET RESTAURUESE TË PARASHIKUARA.....	15



Vendndodhja:

Kadipashaj, është një fshat i vogël, në rrethin e Lushnjës, që pozicionohet në lindje të austostradës Lushnje – Fier, në ultësirën e Myzeqesë, pranë fshatrave Bishqethëm dhe Krutje ndërsa kisha "Shën Todrit", ndodhet në veri të fshatit që sot quhet Arrëz dhe aksesohet nga një rrugë e fshatit, pingul me autostradën Lushnje-Fier. Ajo është shpallur Monument Kulture i Kategorisë së Parë me Urdhër nr. 6, datë 15.01.1963 nga Rektori i Universitetit të Tiranës. Monumenti ndodhet rreth 11 km në jug të Lushnjës dhe rreth 5 km në jug-lindje të rrugës nacionale Lushnjë-Fier. Askesi për në Kishë nuk është i lehtë, pasi nuk ka asnjë lloj tablele informuese dhe rruga që të çon është e ngushtë dhe e pashtuar.




Fig. 1 Vendndodhja e kishës

Monumenti është ndërtuar në një terren të sheshtë, në një parcelë në formë drejtëkëndore të parrethuar dhe pozicionohet në qendër të saj. Rruga që të çon për në kishë është në anën perëndimore të ndërtesës, ndërsa varrezat e fshatit gjenden në perëndim. Pavarësisht terrenit të sheshtë dhe të lehtë për t'u mirëmbajtur, territori përreth ka pak pemë të larta dhe gjelbërim të ulët. Duke parë gjeometrinë e parcelës dhe mundësinë e saj, varrezat përreth mund të sistemohen duke krijuar rradhë të rregullta dhe do të ishte mirë nëse pjesa lindore e parcelës të trajtohej në formën e një kopshti hyrës si dhe të realizohej rrethimi i parcelës së kishës, krijimi i një rruge hyrëse dhe ndoshta edhe i një sheshi përpara hyrjes së ndërtesës. Po ashtu rreth e rrotull kishës, në një distancë prej 5 metrash të mos vendoseshin varre, duke i lënë hapsirë ndërtesës për drenazhim dhe mos ketë shtim dherash në të ardhmen.

Monumenti i përket periudhës pasbizantine, ndërtuar në shek. 19, pikturuar në vitin 1801 dhe është i tipit bazilikal, me muraturë guri deri në gjysëm të lartësisë dhe me muraturë tulle pjesa e sipërme, i suvatur në pjesën më të madhe të sipërfaqes dhe i mbuluar me tavan druri dhe çati me tjegulla. Përbëhet nga naosi me një mafil, narteksi në anën perëndimore me dy kate, hajati në jug në të cilën ndodhet edhe një dhomë për priftin dhe ka një këmbanare pllakë në perëndim. Hyrja bëhet nga hajati në jug dhe një hyrje nga narteksi. E njëjtë është edhe hyrja për në naos.

Interieri i kishës është i veshur me piktura murale të pikturuara nga vëllezërit Çetiri, në pjesën e absidës, ndërsa pjesa tjetër sot është e papikturuar dhe me suva.

Bibliografia: Kishat e Myzeqesë Pirro Thomo.

ANALIZA HISTORIKO – ARKITEKTONIKE

1. PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK

Forma planimetrike e kishës është naos trenefsh, një narteks dy katësh në perëndim, një hajat me kolonadë të hapur në jug dhe një dhomë në këndin jug-perëndimor. Hajati evidentohet lehtë si nga latësia e tij kundrejt naosit dhe narteksit, e cila është dukshëm më e ulët ashtu edhe nga trajtimi i hapur me kolonadë guri dhe tulla të lidhur me harqe. Në perëndim, ngrihet edhe këmbanarja pllakë, e ndërtuar me muraturë tulle. Mbulimi i të gjithë bazilikës, është me çati me konstruksion druri dhe mbulim me tjegulla. Dimensionet e jashtme të kishës janë 22.30 m x 14.30 m.



Fig. 2 Pamje e përgjithshme e kishës

Naosi me plan drejtkëndor, ka dimensione të brendshme të përgjithshme 14.47 m x 8.45 m. Ai ndahet në tre nefe, ku ndarja e tyre bëhet me rresht nga katër kollona druri me seksion katror dhe të veshura me dërrasa. Nefet kanë të gjithë të njëjtën lartësi. Naosi ndahet nga ambienti i altarit nëpërmjet një ikonostasi druri. Mbulimi i naosit bëhet me tavan të rrafshët druri, i cili shkarkon në harqet prej çatmaje të ngritura mbi kolona dhe në muret perimetrale të naosit. Lartësia e brendshme e naosit nga dyshemeja deri në tavanin e drurit është 5,91 m, ndërsa ajo e kulmit të kupolës së drurit që ndodhet në qendër është 6.56 m. Lidhja konstruktive në drejtimin gjatësor të kolonave bëhet me anë të qemerëve me konstruksion të lehtë druri, të cilat nuk kanë lidhje me tiranta druri. Naosi ndriçohet nga pesë dritare në secilën anë, të pozicionuara në pjesën e sipërme të murit verior dhe jugor. Muret e brendshme të naosit janë



të suvatuara, por në pjesën e absidës ka fragmente të mëdhaja të pikturuara. Mure të pikturuar ka edhe në faqen perëndimore dhe në këndet jugore dhe veriore. Në anën perëndimore, ndodhet një mafil, me konstruksion druri, që ngjitesh me shkallë të pozicionuara në pjesën veri-perëndimore.




Fig. 3 Ndarja funksionale



Fig. 4 Pamje e naosit

Narteksi ndodhet në pjesën perëndimore, është dykatësh dhe lidhet me naosin nëpërmjet një dere dhe dy dritareve. Dimensionet e brendshme të tij janë 6.06 x 9.01 m. Në katin përdhe

naosi ka dy kolona guri me seksion katror 50x50 cm. Në pjesën veriore të katit përdhe ndodhet edhe një pagëzimore e vogël me dimensione 64.5x 64.5 x 65 cm. Ndriçimi në këtë kat realizohet nga një dritare të vendosur në murin verior, si dhe ka një derë hyrëse në murin perëndimor. DysHEMEJA e këtij kati është e shtruar me tulla, të vendosura diagonalisht në lidhje me hapsirën, ndërsa si tavan është struktura e ndërkatit prej druri. Shkallët për në katin e parë ndodhen në këndin veri-lindje dhe janë prej konstruksioni druri. Ky kat më tepër dritë me nga dy dritare në murin verior, jugor dhe perëndimor. Mbulimi i këtij kati bëhet me tavan druri. E gjithë hapsira e brendshme është e suvatuar. Në fasadë muri perëndimor kornizohet poshtë çatisë dhe një kornizë horizontale për të krijuar kështu një lloj frontoni, që përfundon me këmbanaren.




Fig. 5 Pamje e katit përdhe



Fig. 6 Pamje e katit të parë

Këmbanarja është një element pllakë në formë drejtëkëndore e vendosur në fasadën perëndimore. Ajo është realizuar me muraturë tulle dhe është e suvatuar. Në konstruksionin e këmbanares janë dy hapira të vogla me hark në të cilat janë vendosur dy trarë për këmbanat e hekurit. Sot njëra këmbanë mungon (ajo në veri). Kreu i murit është në formë të harkuar dhe mbi të është vendosur një shtresë llaçi.




Figura 7 Pamje e këmbanares

Hajati është një harkadë e hapur me kolona në jug, gjatë gjithë gjatësisë së brinjës jugore. Hajati trajtohet i hapur me kolona guri, të lidhura me harqe guri dhe mbushje me tulla dhe muraturë tulle mbi harqet. Në anën perëndimore të hajatit është realizuar një dhomë për priftin, e cila është ndërtuar me muraturë guri. Nga jashtë fasada është e pasuvatuar, duke evidentuar mjaft spoilie të përdorura në kolonat e gurit dhe në harqe, ndërsa muratura e brendshme e hajatit është e suvatuar. Kolonat vendosen mbi një parapet guri, të shtruar me një shtresë me pllaka



guri. Ato janë 8 këndore me kapitule por pa bazamente. Mbulimi është realizuar me çati të pjerrët një ujëse, pa tavan, me konstrukcion me trarë druri dhe të mbuluar me tjegulla, si pjesa tjetër e çatisë. Çatia e tij është shumë më e ulët nga ajo e naosit, duke nxjerrë në pah dritaret e mëdha të naosit në këtë anë. Hyrja për në hajat bëhet nëpërmjet 1 hapsire drite, në fund të kolonadës.



Figura 8 Pamje e jashtme e hajatit




Figura 9 Pamje e brendshme e hajatit




Fig. 10 Pamje e jashtme e ambjentit të mbyllur në hajat



Fig. 11 Pamje e brendshme e ambjentit të mbyllur në hajat

2. ELEMENTËT ARKITEKTONIKË

ABSIDA

Bazilika, ka një ndërtim të thjeshtë por me elementë dekorues interesnatë, sidomos pjesa e abisdës që gjithmonë trajtohet në mënyrë të veçantë. Ajo është 9 faqëshe, ku të bien në sy përfundimi me harqe pak të dala. Teknika e ndërtimit të saj është me gur të skuadruar me dimensione jo të njëjta por të vendosur në rradhë horizontale përgjithsisht të drejta. Në dy apo tre vende evidentohen edhe copa tullash. Muratura kornizohet me 2 rradhë tullash të cilat janë vendosur në mënyrë të alternuar duke u vendosur një rradhë drejt dhe një rradhë në formë dhëmbë sharre. Çdo rradhë del me pak shkallëzim. Në qendër ndodhet një dritare e vogël dhe

mbrojtuar me zgarë metalike. Lidhja e materialeve është realizuar me llaç –gëlqere, me ngjyrë afërsisht në bezhë. Fugat janë trajtuar të holla (rreth 1 cm). Në të gjitha rastet fugat janë rrafsh me materialin ndërtimor dhe nuk e mbulojnë atë. Vihen re se shumë fuga janë realizuar me llaç çimento, pasi ka qenë ndërhyrja që është kryer rreth vitit 2013, për përforcimin e muraturës. Pjesa e xokolaturës është realizuar me mur me gurë të vendosur në mënyrë të çrregullt dhe të lidhur me llaç. Kjo pjesë evidentohet fare lehtë nga muratura e sipërme e absidës, për nga teknika e saj. Mbulimi i absidës është realizuar si pjesa tjetër e kishës, me tjegulla, me një çati në formë gjysëm rrethore, me pjerrësi të ulët.



Fig. 12 Pamje e faqes lindore dhe e absidës

DYERT

Kisha ka dy hyrje kyresore një në naos dhe një në narteks. Sot hyrja kryesore e kishës realizohet nga ana jugore, nëpërmjet hajatit e më pas nëpërmjet një dere në murin jugor të naosit. Këto dyer janë trajtuar me mbulim me qemerë nga jashtë dhe me arkitra druri në brendësi. Dyert janë prej druri, me një dy dhe kanatë me konfiguracion të thjeshtë. Konstruksion të njëjtë ka edhe dera lidhëse e naosit me narteksin. Në portën në perëndim vihen re elemente të cilët janë të ripërdorur (spolie).

Dy dyer të tjera janë më të thjeshta, dhe bëjnë të mundur aksesimin e ambientit të narteksit dhe dhomës së priftit direkt nga hajati. Këto dyer janë me arkitra mbajtës dhe duken se janë të realizuara në një periudhë të dytë.



Fig. 13 Portë në fasadën perëndimore
naos



Fig. 14 Porta hyrëse nga hajati për në




Fig. 15 Portë në fasadën perëndimore

DRITARET

Naosi merr dritë mjaftueshëm me hapjen e 10 dritareve të mëdha në pjesën e sipërme të mureve gjatësore. Dritaret në të gjitha rastet janë drejtëkëndore me dimensione të mëdha, me kasë druri të ndërtuara me arkitrarë druri. Dritaret e narteksit janë më të vogla, por të të njëjtit lloj si ato të naosit. Narteksi ka një dritare në katin përdhe, 2 dritare në murin ndarës me naosin, dhe nga dy dritare për faqe (në total 6) në katin e parë, duke e bërë ambientin e sipërm me shumë dritë.

DYSHEMEJA

Dyshemeja e naosit është e shtruar me pllaka guri, me forma të rregullta kuadratike dhe në qendër të hapsirës është realizuar një motiv rrethor, ndërsa ajo e hajatit dhe narteksit është e shtruar me pllaka qeramike. Kati i parë i narteksit është realizuar me dysheme druri, kurse dhoma e priftit është me dhe.



Fig. 17 Shtrese me pllaka te skuadruara guri ne naos *Fig. 18 Shtrese me rrasa guri te*
crregullta ne abside




Fig. 18 Shtrese me rrasa guri te




Fig. 17 Shtrese me tulla te kuqe ne narteks
hajati



Fig. 18 Shtrese me tulla te kuge ne

TAVANET

Naosi dhe narteksi në katin e parë janë trajtuar me tavan. Në naos tavanin është i rrafshët, i pikturuar dhe me dekoracion të thjeshtë. Tavanin është trajtuar me ndarje kuadratike, dhe vetëm në qendër ngrihet një kupolë gjysëm sferike. Tavanin e narteksit është më i thjeshtë dhe i papikturuar.





Fig. 19 Pamje e tavanit të drurit në naos

Fig. 20 Pamje e tavanit të drurit në amjentin e gjinekonitit




Fig. 19 Pamje e tavanit te drurit ne naos Fig. 20 Pamje e tavanit te drurit ne amjentin e gjinekonitit

MAFILI

Në anën perëndimore ngrihet një mafil me konstruksion druri, i cili sipas mbahet në 2 kolona me seksione katrore prej druri dhe mbështetet në trarë druri në muret gjatësore. Mafili është i ngushtë dhe del lehtë mbi pjesën e sallës qendrore. Shkallët që të çojnë për në mafil janë në këndin veri-perëndimor dhe janë me konstruksion druri.



Fig. 21 Pamje e Mafilit (gjinekonitit)

ELEMENTËT DEKORATIVË

Interieri i kishës është i mobiluar me karrike druri, ambon e ikonostas.




Fig. 22 Pamje e Mafilit (gjinekonitit)


3. TEKNIKA E NDËRTIMIT

Kisha, i përket tipologjisë së kishave të zonës së Myzeqesë, të ndërtuara rreth shekullit 19-të, të cilat janë ndërtuar me muraturë guri për muret perimetralë, ndërsa kollonat e brendshme me konstruksion druri dhe konstruksion çatmaje.

Muret perimetralë janë të ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqere dhe të vendosur në mënyrë të çrregullt dhe më pas të suvatuar nga jashtë e brenda. Gjithashtu në muraturë dallohen breza me 3 rreshta tullash. Veçanti i kësaj kisha është muratura e sipërme e naosit dhe narteksit cila është realizuar me mur tulle, më të hollë se ajo e gurit. Trashësia e muraturës së naosit është 85 cm ndërsa muratura e narteksit është 65 cm. Hajati dallohet për nga konstruksioni me kollona dhe qemrë guri, të vendosur mbi një parapet guri dhe mbushjen e murit të sipërm me mur tulle. Sot muratura e jashtme e tij është e pasuvatuar, ndërsa ajo e brendshme është e suvatuar. Zona e dhomës së priftit është e realizuar me muraturë guri e lidhur me llaç dhe e suvatuar në interior.

Mbulimi i saj realizohet, me konstruksion druri dhe me çati me tjegulla. Naosi dhe narteksi në brendësi ka mbulim me tavan të rrafshët, prej druri ndërsa hajati dhe dhoma e priftit nuk kanë tavan dhe evidentohet konstruksioni i çatisë.

Fasadat janë përgjithësisht të suvatuara, ndërsa fasada lindore, muri i poshtëm i gurit është e pasuvatuar. Pjesë të mëdhaja të muraturës që janë të pasuvatura (në hajat, në murin perëndimor dhe atë verior) janë pjesë muri të cilat në origjinë kanë qenë të suvatuara, por që i është dëmtuar apo prishur suvaja.



4. RILEVIME/PROJEKTE TË VJETRA NGA ARKIVI I IKTK-së




Fig. 23- 24 Rilevime te kishesh se Shen Todrit_Kadipashaj (viti 1979 - Arkivi I IKTK)




Fig. 25 Projekt konsolidimi restaurimi nga arkivi i IKTK-se i vitit 1986

Projekti i vitit 1986 parashikon:

- Ndertimin e nje themeli konsolidues per absiden me qellim parandalimin e uljeve te metejshme;
- Ndertimi i nje brezi betoni armeje per kreun e murit te absides i cili do te beje njekohesisht edhe inkastimin me muret e tjere te kishes;
- Qepje e carjeve ne murature me solucion gelqereje;
- Ndertim i nje brezi beton armeje ne te gjitha muraturen e kishes i cili do te sherbeje si lidhez intisizmik;
- Vendosja e tiranteve metalik mbi nivelin e tavanit me qellim lidhjen e murit jugor me ate verior te kishes;
- Punime per riparimin dhe restaurimin e elementeve drusore te catise;
- Qeramosje e catise;
- Riparime e restaurime te kornizave;
- Vendosje e ullukeve prej llamarine si ne strehet ashtu edhe ne pikat e takimit te catise se hajateve me muret e kishes;
- Germim dheu dhe ulje e nivelit te terrenit deri ne nje largesi prej 2 m larg mureve perimetral te kishes. Kuota e re duhet te jete 20 cm me e ulet ne piken me te larte te saj;
- Hapje kanali per drenazhimin e ujerave;
- Hapje kanali per largimin e ujerave siperfaqesor;

Projekt Restaurimi- "Kisha e Shën Todrit", Kadipashaj, Lushnjë

- Restaurime te mureve te kishes;
- Punime pastrimi dhe sistemimi;
- Riparime dhe restaurime te shtreses se dysHEMEVE te kishes;
- F.V. dyer dhe dritare te jashtme e te brendshme;
- F.V. zgara metalike per dritaret;
- Lyerje me vaj lini i gjithë elementeve drusore;




Fig. 26-27 Relacion teknik nga arkivi i IKTK-se i vitit 1986



Projekt Restaurimi- "Kisha e Shën Todrit", Kadipashaj, Lushnjë




Fig. 28 Projekt konsolidimi restaurimi nga arkivi i IKTK-se i vitit 1990

Projekti i vitit 1990 parashikon:

- Germim dhe transport dherash;
- Hidroizolim me dy shtresa leter;
- Shtrim me pllaka betoni;
- Perforcim nen themeli me mur tulle 25 cm lartesi;
- Ndertim mur guri;
- Puntelim e pajantim te mureve te kishes;




Fig. 29-30 Relacion teknik nga arkivi i IKTK-se i vitit 1986




Fig. 31-32 Projekt restaurimi nga arkivi i IKTK-se i vitit 2006

Projekti i vitit 2006 parashikon:



- Sondazhe gërmimi në të gjithë sipërfaqen e themeleve
- Perforcim i themelit të absides, zgare hekuri dhe beton marka e lartë;
- Ndërtim jastik mbajtes b/a në pjesët e tjera të themeleve ku ka çarje të tij;
- Ndërtim brez b/a (te maskuar) në krahun e murit të absides i cili do të inkastrohet në të dy krahët e murit lindor;
- Ndërtim i brezit b/a (te maskuar) në kreun e sipërmit të murit perimetral tekishës, i cili do të shërbejë njëkohësisht si lidhës antisizmik;
- Vendosja e tiranteve metalike mbi nivelin e tavanit, të futura kokat e tyre në brezin b/a;
- Rindërtim i catisë së kishës dhe hajateve duke ruajtur elementet e vjetër origjinal që janë të pakalbur;

Projekti i vitit 2012 parashikon:



- Themel e xokol betoni C - 7/10 (vendosja e jastëkut të betonit për përforcimin e themelit në qoshen verilindore);
- Restaurim çatie tjegulla vendi (Zëvendësimi do të realizohet vetëm për elementet e degraduar);


Projekt Restaurimi- "Kisha e Shën Todrit", Kadipashaj, Lushnjë

- Restaurim i pjesës së murit të gurit në anën veriore të absidës me teknikën shqep – qep (sipas specifikimeve teknike dhe shpjegimeve grafike);
- Qepja e çarjeve në murin lindor të kishës me shufra hekuri Ø-6 mm me gjatësi 40 cm të vendosura në 40 cm largësi njera mbi tjetren;
- Restaurim i çarjeve në murin lindor me anë të injektimit (çmimi përfshin të gjithë procesin e injektimit duke filluar që nga pastrimi i fugave të çarjes me furçë dhe larje me ujë me presion dhe mbyllja e të gjitha vrimave anësore, çpimi i vrimave dhe vendosja e tubave të injektimit, përgatitja e mishelës për injektim - në bazë të specifikimeve teknike - larja e muraturës nga brenda, injektimi i mishelës dhe stukimi i vrimave me llaç gëlqere hidraulike + pozolan, dhe çdo punim tjetër të nevojshëm për përfundimin e procesit)
- Ndërtim i strukturës së shkallëve me material druri (për ngjitje në mafil - do të përdoret dru pishe i stazhionuar);
- Suva brenda mur guri me krah, llaç i perzier M 25 (Muri perëndimor i naosit - pjesa poshtë mafilit);
- Sherbetisje e bojatisje me gëlqere (Muri perëndimor i naosit - komplet);
- F.V. derë druri (dru pishe i stazhionuar);
- F.V. dritare druri;
- Ndërtim dysHEME me rrasa guri mbi shtresë betoni në ambjentin e absidës;
- Pastrim dhe fugatim muri guri me llaç gëlqere 1:3 (e gjithë muratura e gurit - fasadat e jashtme);
- Prishje e suvatimit ekzistues (në muraturën me tulla të kishës - fasadat e jashtme + Këmbanarja);
- Shtresë betoni M 150 (nënshtresë + kunetë e trotuarit përgjatë gjithë perimetrit të kishës);
- Soleta të plota b/a C 16/20 (urat që shërbejnë për hyrjen në kishë);
- Shtresë me pllaka guri (trotuari përgjatë gjithë perimetrit të kishës + urat);




Projekt Restaurimi- "Kisha e Shën Todrit", Kadipashaj, Lushnjë







5. FOTO TË VJETRA NGJA ARKIVI I IKTK-së



34771





33989





33990

33980

Projekt Restaurimi- "Kisha e Shën Todrit", Kadipashaj, Lushnjë





6. GJENDJA E KONSERVIMIT E KISHËS

Sipas dokumentacioneve dhe inspektimit në vend, ndërtesa ka shfaqur probleme serioze në të kaluarën. Dokumentohen përgjithësisht të njëjtat problematika për të cilën janë propozuar disa lloj ndërhyrjesh të ndryshme në vite. Sot, monumenti i shfaq ende disa nga këto problematika, të cilat janë karakteristike në këtë zonë por të cilat vijnë edhe nga terreni në të cilin është ndërtuar kisha.

- Një ndër problemet kryesore të ndërtesës, që vjen nga lloji i tokës ku është ndërtuar, janë **uljet e objektit**, sidomos muratura lindore. Kjo muraturë dokumentohet se ka pasur dëmtime të vazhdueshme ndër vite, si: çarje të mëdha, shkëputje të mureve, plasaritje. E gjithë pjesa lindore duket se ka pësuar çëdim. Për këtë arsye janë propozuar disa herë përforcime themeli, përforcim kreu murature (sidomos në murin e absidës), tirantime, restaurime me teknikën shqep-qep (duke iu referuar projekteve që ndodhen në arkivin e IKTK-se). Është realizuar ndërhyrja me teknikën shqep-qep në murin

lindor, në anën veriore (evidentohet në fletët grafike), është kryer betonimi i themelit të absidës.

- Problematika tjetër e hasur është **lagështia që vjen nga çatia**, në të gjithë pjesën e brendshme të kishës, e cila duket qartë në tavanet e dëmtuara, kalbjen e elementëve drusorë të çatisë dhe nëpër muret e kishës. Për kontrollin e çatisë duhet të zbulohet fillimisht çatia nga tjegullat, dhe të inspektohet hollësisht gjendja e elementëve të drurit, petavrave dhe gjendja e tjegullave.
- Evidentohet gjithashtu **lagështia kapilare** përreth gjithë kishës, e cila vjen si pasojë thellësisë së vogël të trotuarit përreth që luan edhe rolin e kanalit kullues. Kjo lagështi shfaq probleme duke filluar nga suvatimi, degradimi i lidhësit të muraturës. Një tjetër problematikë vërehet në shkarkimin e ujërave që vijnë nga kuneta parametrare në tubin shkarkues aktual prej betoni, i cili është i bllokuar dhe nuk arrin të shkarkojë ujërat sipërfaqësorë në kanal.
- Në murin jugor të naosit, tek zona e derës hyrëse shihet **shkëputja e dy pareteve anesore të muraturës**, duke krijuar mbufatje dhe krijuar hapje në mur, rreth 7 cm. Ky fenomen vjen si pasojë e murit të naosit i cili ka një lartësi mjaft të madhe duke ushtruar shtypje. Ndërhyrja në këtë rast është më e ndërlikuar, pasi të dyja paretet e murit të naosit janë me pikturë murale. Kështu ndërhyrja, përveç se të plotësojë me mbushje dy paretet e muraturës dhe t'i konsolidojë ato, ajo duhet të konsistojë në krijimin e skemave lidhëse midis këtyre muraturave për forcimin e tyre.
- Të gjithë elementët drusorë, konstruktiv dhe dekorues për shkak të insekteve dhe lagështisë së vazhdueshme, kanë nevojë për disinfektim, konsolidim dhe trajtimin e nevojshëm.
- Dyshemeja _ është në gjendje përgjithësisht të mire.
- Piktura murale, ikonostasi, karriket _ kanë nevojë për ndërhyrje, sidomos piktura murale (pjesa e mbetur dhe ajo e shkëputur që ruhet në mafil), e cila ka dëmtime të mëdha nga lagështia.
- Në fasadë, ka presencë të madhe të patinës biologjike, të cilat ndikojnë në rritjen e lagështisë në muraturë.
- Elementët e çatisë së hajatit janë tepër të degraduar dhe kanë pësuar përkulje/bark për nga poshtë si pasojë e peshës së tjegullave dhe kalbëzimit të strukturës drusore.
- Dyshemeja në hajat në gjendje relativisht të mirë por ka nevojë për pastrim dhe mirëmbajtje, ndërsa dhoma e priftit është e pashtuar me dysheme tullë baltë të plota.
- Dyshemeja e katit përdhe në Narteks është e shtruar me tulla të kuqe dhe ka nevojë për pastrim. Dyshemeja e katit të sipërm të narteksit është prej druri dhe paraqet prezencë lagështie si pasojë e infiltrimit të ujërave të shiut nga çatisë.
- Tavani i ambientit të narteksit në katin e sipërm është i thjeshtë. Tavani është tepër i degraduar dhe me lagështirë, si pasojë e depërtimit të lagështisë nga sipër çatisë.



Gjithashtu vërehet se ai është shkëputur nga trarët e çatisë dhe ka krijuar bark për nga brenda.

- Dyert janë të degraduara me presencë lagështie në bazamentin e poshtëm të tyre. Dritaret edhe pse janë relativisht të reja kanë nevojë për trajtim. 3 dritare kanë nevojë për zëvendësim.

Drenazhimi është realizuar gjat viti 2021-22. Drenazhimi është realizuar i hapur prej betoni, përreth gjithë perimetrit të kishës me shtrim me beton dhe me pjerrësi të lehtë, si dhe ka dy tuba shkarkimi në pjesën veriore dhe perëndimore. Thellësia e tij nga kuota e hajatit shkon rreth 45 cm kanali më shkarkim ujrash. Sipas konstatimeve në vend u vërejt se në pjesën e trotuarit në faqen veriore të objektit ka prezencë lagështie. Kjo të lehtë kuptosh se tubi shkarkues të ujerave për në kanal është i bllokuar pasi pjesa e përparme e tij është lenë e hapur duke lejuar kështu depërtimin e mbeturinave dhe dherave që vijnë me vërshimin e ujerave sipërfaqësore.

Për zgjidhjen e këtij problemi është menduar që ky tub të priset pasi është e pamundur që të zhblokohet duke qenë se ka një shtrirje relativisht të gjatë, dhe të zëvendësohet me një kanal të hapur në formën e një kunete i cili do të realizohet me kanalina betoni dhe të mbuluar kapak për mos depërtimin e mbetjeve. Në këtë mënyrë është e mundur pastrimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e këtij sistemi drenazhimi të hapur, për largimin e ujerave sipërfaqësore nga themelet e kishës.

Për të evituar lagështinë/kapilaritetin në pjesën e poshtme të muraturës, është menduar që trotuari aktual brej betoni të hiqet, dhe kanali i drenazhit të thellohet. Trotuari i ri parashikohet të realizohet me nenshtresë b/a i varfër (ku dotë realizohet edhe kuneta) dhe mbi të shtrohet me kalldrëm. Fugatimi të realizohet me llaç hidraulik.

1. SHKAKU I DEGRADIMEVE NË MËNYRË TË PËRMBLEDHUR

- Prezencë bimësi e ulët në muraturen e kishës dhe ambientin përreth saj;
- Degradim i materialit lidhës në muraturë si pasojë e infiltrimit të ujerave sipërfaqësorë;
- Prezencë lagështie në bazamentin e poshtëm të muratores në gjithë perimetrin e kishës, si pasojë e thellësisë së vogël të kanalit të drenazhimit dhe bllokimit të tubit shkarkues i cili nuk arrin të shkarkojë ujerat sipërfaqësorë që grumbullohen në kunatën perimetrale të kishës;
- Çarje gjatësore ekzistuese në muratoren e kishës, të evidentuara po në të njëjtat gjendje që prej viti 2010;
- Degradim i dyerve/dritareve të drurit;
- Dëmtim/shkëputje e dy pareteve anësore të muratores mbi portën hyrëse për të Naosit;
- Degradim i çatisë me tjegulla vendi dhe elementeve drusore përbërës të saj;
- Degradim i tavanit të drurit në katin e sipërm të ambientit të Narteksit;
- Degradim i dyshemesë së drurit së bashku me shkallet dhe korimanot prej druri në ambientin e gjinekonitit në Naos si dhe në Narteks;
- Degradim i bazamentit të poshtë të kolonave prej druri në Naos si pasojë e lagështisë;
- Degradim i ndenjësve prej druri në Naos;
- Mungesë e dyshemesë prej tulle në dhomën e priftit.



7. NDËRHJRJET E PROPOZUARA

Ndërhyrjet e propozuara do të konsistojnë si më poshtë:



- Pastrim mekanik i bimësisë në muraturë dhe në ambientin përreth kishës, spërkatje me herbicid;
- Restaurim i suvasë së degraduar, larje e muratures, pastrim nga patina biologjike dhe bimësia e ulet në muraturë, larje me ujë të bollshëm, lysterje e fasadës me gëlqere ;
- Prishje e trotuarit ekzistues. Thëllimi i trotuarit perimetral. Pasi të jete thelluar trotuari do të behet shtrimi me kalldrëmi 15-20 cm mbi shtrese llaç M-25 dhe mbushje me rëre e fugave.
- Injektivim i çarjeve ekzistuese në muraturë me llaç gëlqere;
- V.F i disa prej dritareve të drurit të munguara apo në gjendje teje të degraduara;
- Restaurim i dyerve dhe dritare druri të degraduara;
- Restaurim i çatisë dhe hidroizolim i saj;
- Restaurim i dyshemesë, shkalleve dhe koromaneve të drurit;
- Shtrim i dyshemesë në dhomën e priftit me tulla të kuqe në forme rate mbi shtrese rëre;


8. FOTO TE MONUMENTIT _GJENDJA EKZISTUESE JANAR 2025





Projekt Restaurimi- "Kisha e Shën Todrit", Kadipashaj, Lushnjë
















Projekt Restaurimi- "Kisha e Shën Todrit", Kadipashaj, Lushnjë



Ronela
cuku

Digitally signed by
Ronela cuku
Date: 2025.04.01
10:56:43 +02'00'

SEKTORI I ARKITEKTURES ANTIKO MESJETARE GRUPI I PROJEKTIMIT: Ark. Ronela Çuku; Ing. Bledjan Rakipi

